REKOMANDIMI REC(2004)4

I KOMITETIT TË MINISTRAVE PËR SHTETET ANËTARE LIDHUR ME KONVENTËN EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË ARSIMIN E LARTË/UNIVERSITAR DHE KUALIFIKIMIN PROFESIONAL

(Miratuar më 12 maj 2004, gjatë sesionit të 114 të Komitetit të Ministrave (12-13 maj 2004)

Komiteti i Ministrave, në përputhje me nenin 15.b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke patur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të tij, dhe se një nga mjetet më të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi është mbrojtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke përsëritur bindjen e tij, se Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (këtej e më tutje referuar si "Konventa") duhet të mbetet pikë referimi esenciale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë, dhe duke kujtuar angazhimin e tij për të marrë masat që synojnë të garantojë efektshmërinë afatgjatë të sistemit kontrollues, të krijuar nga Konventa;

Duke sjellë në mëndje se në zbatim të nenit 1, karakteri ndihmës i mekanizmit të mbikëqyrjes, të themeluar nga Konventa, nënkupton që të drejtat dhe liritë e garantuara nga Konventa mbrohen në radhë të parë në nivel kombëtar dhe zbatohen nga autoritetet kombëtare;

Duke mirëpritur, në këtë kuadër, se Konventa është bërë tashmë pjesë përbërëse e legjislacionit të brendshëm të të gjitha shteteve palë;

Duke theksuar rolin parandalues, që luan edukimi me parimet në frymën e Konventës dhe standardet, që ajo përmban si dhe jurisprudencën, që është krijuar prej tyre;

Duke kujtuar se masat për lehtësimin e publikimit dhe shpërndarjes së gjerë të tekstit të Konventës dhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (këtej e më tutje referuar si "Gjykata") në shtetet anëtare janë të rëndësishme për sigurimin e zbatimit të Konventës në nivel kombëtar, sikurse theksohet në Rekomandimin REC (2002) 13, është vendimtare që ato të plotësohen nga masa të tjera në fushën e arsimit dhe kualifikimit profesional me synim arritjen e qëllimit të tyre;

Duke theksuar rëndësinë e veçantë të arsimit universitar përkatës dhe të programeve kualifikuese profesionale, për të garantuar se institucionet publike, përfshi të gjithë sektorët përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë, zbatojnë efektivisht Konventën, në dritën e jurisprudencës së Gjykatës;

Duke kujtuar rezolutat dhe rekomandimet, që ka miratuar tashmë Komiteti i Ministrave mbi aspekte të ndryshme të edukimit të të drejtave të njeriut, veçanërisht: Rezoluta (78) 41 mbi mësimin e të drejtave të njeriut; Rezoluta (78) 40 që përmban rregullat mbi bursat e Këshillit të Europës për studime dhe kërkime në fushën e të drejtave të njeriut; Rekomandimi nr. R (79) 16 lidhur me mbështetjen e kërkimeve për të drejtat e njeriut në shtetet anëtare të Këshillit të Europës; Rekomandimi nr. R (85) 7 lidhur me mësimdhënien dhe mësimin e të drejtave të njeriut në shkollë, si edhe shtojcën e këtij rekomandimi, që përmban sugjerime lidhur me mësimdhënien dhe mësimin e të drejtave të njeriut në shkollë;

Duke kujtuar rolin, që mund të luajnë institucionet kombëtare për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht në fushën e kualifikimit të stafit përgjegjës për zbatimin e ligjit, dhe duke mirëpritur iniciativat e ndërmarra tashmë në këtë drejtim;

Duke marrë në konsideratë diversitetin e traditave dhe eksperiencën në shtetet anëtare në drejtim të arsimit universitar, kualifikimit profesional dhe rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me sistemin e Konventës:

Rekomandon që shtetet anëtare:

Të sigurojnë edukim universitar të mjaftueshëm dhe kualifikime profesionale lidhur

me Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës në nivel kombëtar dhe këto të jenë të përfshira, në veçanti:

- si pjesë përbërëse e programit mësimor të përbashkët mbi të drejtën dhe, kur është e përshtatshme, të titujve në shkencat politike dhe administrative dhe veç kësaj, ato ofrohen si degë fakultative për ata që dëshirojnë të specializohen;
- si pjesë përbërëse e programeve përgatitëse të provimeve kombëtare ose lokale për t'u pranuar në profesione të ndryshme ligjore dhe për kualifikimin fillestar dhe të vazhdueshëm që u ofrohet gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve;
- në kualifikimet fillestare dhe të vazhdueshme që i ofrohen personelit në sektorët e tjerë përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe/ose personelit që punon me personat e privuar nga liria (për shembull oficerët e policisë dhe forcave të sigurisë, personeli i burgjeve dhe i spitaleve) si edhe personelit të shërbimeve të migracionit, në një mënyrë që merr në konsideratë nevojat e tyre specifike.

Të rrisin efektivitetin e arsimit universitar dhe kualifikimeve profesionale në këtë fushë, veçanërisht përmes:

- marrjes së masave që arsimi dhe kualifikimet të përfshihen në struktura të qëndrueshme - publike dhe private – dhe dhënia e tyre të realizohet nga persona që kanë njohuri të kënaqshme për konceptet e Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës, si edhe njohuri të mjaftueshme për teknikat e kualifikimit profesional;
- duke mbështetur iniciativat që synojnë kualifikimin e profesorëve dhe trajnerëve të specializuar në këtë fushë.

Të inkurajojnë iniciativat joshtetërore për nxitjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive për sistemin e Konventës, të tilla si krijimi i strukturave të posaçme për mësimdhënien dhe kërkimet në legjislacionin për të drejtat e njeriut, improvizimi i seancave gjyqësore të ngjashme me ato të Gjykatës Europiane, fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit;

Udhëzon Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës t'ua përcjellë këtë rekomandim qeverive të atyre shteteve palë në Konventën Kulturore Europiane, që nuk janë anëtare të Këshillit të Europës.

SHTOJCË E REKOMANDIMIT REC(2004)4

Hyrje

1. Konferenca Ministeriale, mbajtur në Romë më 3 dhe 4 nëntor 2000 për të festuar 50 vjetorin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (këtej e më tutje referuar si "Konventa") ftoi shtetet anëtare të Këshillit të Europës "të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të zhvillohet dhe mbështetet arsimimi dhe ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut në të gjithë sektorët e shoqërisë, duke vënë theksin veçanërisht tek profesionet ligjore".

2. Ky angazhim që duhet të përmbushin autoritetet kombëtare vjen si pasojë e karakterit ndihmës të mekanizmit mbikëqyrës të krijuar nga Konventa, që nënkupton se të drejtat e garantuara nga Konventa janë të mbrojtura në mënyrë të plotë, në radhë të parë në nivel kombëtar dhe zbatohen nga autoritetet kombëtare. Komiteti i Ministrave ka miratuar tashmë rezoluta dhe rekomandime, që trajtojnë aspekte të ndryshme të kësaj çështje, dhe inkurajojnë nismat që mund të ndërmerren, veçanërisht nga institucionet kombëtare të pavarura për të drejtat e njeriut dhe OJQ-të, që synojnë të nxisin një mirëkuptim dhe ndërgjegjësim më të madh të Konventës dhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (këtej e më tutje referuar si "Gjykata").

3. Garantimi i efektshmërisë afatgjatë të sistemit të Konventës është ndër prioritetet aktuale të Këshillit të Europës dhe, në këtë kontekst, konsiderohet si faktor thelbësor nevoja për një zbatim më të mirë të Konventës në nivel kombëtar. Kështu, është e nevojshme që të gjitha shtetet anëtare të garantojnë ofrimin e një arsimi të mjaftueshëm mbi Konventën, veçanërisht përsa i përket profesioneve ligjore dhe institucioneve zbatuese të ligjit. Në njërën anë, kjo mund të ndikojë në uljen e numrit të shkeljeve të të drejtave të garantuara nga Konventa, që vijnë si pasojë e njohjes së pamjaftueshme të Konventës, dhe, nga ana tjetër,

në uljen e kërkesave të paraqitura që në mënyrë të qartë nuk plotësojnë kriteret për pranueshmëri.

Ky rekomandim u referohet tre kategorive të veprimeve plotësuese, konkretisht:

i) përfshirja e arsimimit dhe trajnimeve të përshtatshme mbi Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës, veçanërisht në kuadër të studimeve universitare për drejtësi dhe shkenca politike, si edhe kualifikimet profesionale të profesioneve ligjore dhe zbatuese të ligjit;

ii) garantimi i efektshmërisë së arsimimit dhe kualifikimit, që nënkupton në veçanti, një kualifikim të nevojshëm për mësuesit dhe trajnerët; dhe

iii) inkurajimi i nismave për nxitjen e njohurive dhe/ose ndërgjegjësimit për sistemin e konventës.

5. Duke pasur në vëmendje diversitetin e traditave dhe eksperiencave në shtetet anëtare në drejtim të arsimit universitar, kualifikimeve profesionale dhe rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me Konventën, është përgjegjësi e shteteve anëtare të hartojnë programet e tyre arsimore sipas kushteve kombëtare respektive për secilin prej tyre, në përputhje me parimin e ndihmës, duke garantuar se standardet e Konventës janë prezantuar plotësisht.

ARSIMI UNIVERSITAR DHE KUALIFIKIMET PROFESIONALE

6. Shtetet anëtare ftohen të sigurojnë edukim të mjaftueshëm mbi Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës, të përfshirë në planin mësimor të degëve universitare për drejtësinë dhe provimin e avokatisë, si edhe në kualifikimet e vazhdueshme të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve.

ARSIMI UNIVERSITAR

7. Është thelbësore që edukimi mbi Konventën të përfshihet në mënyrë të plotë në programet e fakulteteve të drejtësisë, jo vetëm si një lëndë e pavarur, por gjithashtu edhe horizontalisht në çdo disiplinë ligjore (e drejta penale, e drejta civile etj.) kështu që studentët e drejtësisë në momentin e diplomimit, pavarësisht nga specializimi, kanë njohuri mbi implikimet e Konventës në fushën e tyre.

8. Duhet të inkurajohet krijimi i studimeve pasuniversitare të specializuara për Konventën, të tilla si tituj të caktuar masteri në nivel kombëtar ose Master Europian për të drejtat e njeriut dhe demokracinë (E.Ma), të cilat përfshijnë 27 universitete nga mbi 15 shtete europiane, si edhe programe universitare më të shkurtëra, të tilla si kurse verore të Institutit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut Rene Cassin (Strasburg) ose të Insitutit Universitar Europian (Florence).

Kualifikimet profesionale

9. Kualifikimet profesionale duhet të lehtësojnë përfshirjen më të mirë të standardeve të Konventës dhe jurisprudencës së Gjykatës në arsyetimet që gjykatat vendase adaptojnë në vendimet e tyre. Për më tepër, ndihma ligjore që mund t'u jepet ankuesve potencialë nga avokatët që kanë njohuri të mjaftueshme për Konventën, mund të parandalojë kërkesat që haptazi nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë. Veç kësaj, njohja më e mirë e Konventës nga profesionet ligjore, do të kontribuojë në uljen e numrit të kërkesave që mbërrijnë në Gjykatë.

10. Kualifikime të veçanta mbi Konventën dhe standardet e saj duhet të përfshihen në programet e shkollave ligjore dhe shkollave për gjyqtarë dhe prokurorë. Kjo mund të shtrojë nevojën e organizimit të seminareve, si pjesë e kualifikimit profesional për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët. Përsa u takon avokatëve, seminare të tilla mund të organizohen për shembull, me iniciativën e Dhomës së Avokatëve. Referencë mund të bëhet në një projekt aktual në kuadër të Dhomës Ndërkombëtare të Avokatëve, me asistencën e Gjykatës, për kualifikimin e avokatëve lidhur me rregullat e procedurës të Gjykatës dhe praktikës së gjykimit, si edhe të ekzekutimit të vendimeve. Në disa vende, Ministria e Drejtësisë ka për detyrë të rrisë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve në kualifikimet mbi

jurisprudencën e Gjykatës Europiane: gjyqtarët në detyrë mund të kenë avantazhin e sesioneve të një ose dy ditëve të organizuara në juridiksionin e tyre dhe të një trajnimi prej një jave çdo vit; “auditori i drejtësisë” (studentëve gjyqtarë) u ofrohen kualifikime të organizuara brenda shkollave kombëtare të gjyqtarëve (shkollat e magjistraturës). Gjithashtu, seminare janë organizuar rregullisht në kuadër të kualifikimit fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve.

11. Për më tepër, seminare dhe kolokiume mbi Konventën mund të organizohen rregullisht për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët.

12. Veç kësaj, një revistë me jurisprudencën e Gjykatës mund të publikohet rregullisht për gjyqtarët dhe avokatët. Në disa shtete anëtare, Ministria e Drejtësisë publikon një botim, që përmban referenca për jurisprudencën e Gjykatës dhe çështje lidhur me Konventën. Ky publikim u shpërndahet të gjitha gjykatave.

13. Rekomadohet që shtetet anëtare të garantojnë përfshirjen e standardeve të Konventës në kualifikimet profesionale fillestare dhe të vazhdueshme për profesionet e tjera të lidhura me zbatimin e ligjit dhe ndalimin e shtetasve, të tilla si forcat e sigurisë, oficerët e policisë dhe personeli i burgjeve, por gjithashtu edhe shërbimet e migracionit, spitalet etj. Kualifikimi vazhdues mbi standardet e Konventës është vecanërisht i rëndësishëm, duke pasur parasysh natyrën evoluese të interpretimit dhe zbatimit të këtyre standardeve në jurisprudencën e gjykatës. Stafi i institucioneve që punojnë me personat e privuar nga liria, duhet të ketë informacion për të drejtat e këtyre personave, ashtu si garantohen nga Konventa dhe si interpretohen nga Gjykata, me qëllim që të parandalohet çdo shkelje, veçanërisht e nenit 3, 5 dhe 8. Rrjedhimisht, është tepër e rëndësishme që në çdo shtet anëtar të ketë kualifikime të përshtatshme të këtyre profesioneve.

14. Një kurs kuafikimi specifik mbi Konventën dhe standardet e saj dhe, në veçanti, mbi aspekte të lidhura me të drejtat e personave të privuar nga liria, duhet të përfshihet në programet e shkollave të policisë, si edhe në shkollat që përgatisin gardianë burgu. Seminare mundet gjithashtu të organizohen si pjesë e kualifikimit të vazhdueshëm të anëtarëve të forcave të sigurisë, gardianëve dhe autorieteve të tjera të interesuara.

Efektiviteti i arsimimit universitar dhe kualifikimit profesional.

15. Për këtë qëllim, shteteve anëtare u rekomandohet të garantojnë se brenda strukturave të përhershme (publike dhe private), arsimi universitar dhe kualifikimi professional në këtë fushë zhvillohen nga mësues dhe trajnues të mirëkualifikuar.

16. Në këtë drejtim, kualifikimi i mësuesve dhe trajnuesve përbën një prioritet. Qëllimi është të garantohet se niveli i njohurive të tyre korrespondon me evoluimin e jurisprudencës së Gjykatës dhe përmbush nevojat specifike të secilit sektor profesional. Shtetet anëtare ftohen të mbështetin iniciativat (kërkime në fushat që mbulon Konventa, teknikat e mësimdhënies etj), që synojnë garantimin e një kualifikimi cilësor të mësuesve të specializuar dhe trajnuesve në këtë fushë evoluese dhe sensitive.

Mbështetja e njohurive dhe/ose ndërgjegjësimit mbi sistemin e Konventës.

17. Në përfundim, shteteve anëtare u rekomandohet të inkurajojnë nismat për mbështetjen e njohurive dhe/ose ndërgjegjësimit mbi sistemin e Konventës. Këto nisma, që mund të jenë në forma të ndryshme, kanë qenë të dobishme në të kaluarën, sa herë që janë iniciuar dhe për rrjedhojë duhet të inkurajohen nga shtetet anëtare.

18. Një shembull mund të jetë ngritja e një strukture konkurrimi për studentët e drejtësisë mbi Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës, duke përfshirë në të njëjtën kohë edhe studentët, profesorët universitarë dhe profesionet ligjore (gjyqtarë, prokurorë, avokatë), p.sh. konkursi i Sporrong dhe Lonnroth, organizuar nga Gjykata e Lartë e vendeve nordike, dhe konkurrimi mbareuropian Rene Cassin i frankofonëve, organizuar nga shoqata e Juris Ludi në ambientet e Këshillit të Europës.